

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Frymëzimi / *ilhaam* / إلهام

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

" قَالَ الَّذِي عِنْدَهُ عِلْمٌ مِّنَ الْكِتَابِ أَنَا آتِيكَ بِهِ قَبْلَ أَنْ يَرْتَدَّ إِلَيْكَ طَرْفُكَ "

“Ai i cili kishte dije nga Shpallja, tha: ‘Unë do të ta sjell para se t’i mbyllësh e t’i hapësh qepallat (një herë).’” (en-Neml, 40)

*ilhaam*¹ është shkalla e *muhaddethiin*.² Kjo është mbi shkallën e *firaaseh* (mprehtësisë shpirtërore), sepse *firaaseh* mund të ndodhë rrallë dhe

¹ *ilhaam* do të thotë t’ia përcjellësh dijen/udhëzimin dikujt duke i bërë me shenjë, me gjest, me anë të një instruksioni të hollë ose me komunikim privat. Kjo më së miri përkthehet si frymëzim. Mirëpo, në arabisht ka nivele të ndryshme të frymëzimit, të cilët kanë edhe emra të veçantë. *ilhaam* është një nga këta emra. Njerëzit nuk janë të një mendjeje për sa i përket pozitës së *ilhaamit* mes formave të tjera të frymëzimit. Sidoqoftë, pavarësisht nga dallimet mes dijetarëve lidhur me pozitën e *ilhaamit* në epistemologjinë islamike dhe ndjekjen e udhëzimit (*hidajeh*), dijetarët pajtohen se *ilhaami* ka një shkallë shumë më të ulët të qartësisë dhe të sigurisë sesa Shpallja (*wahji*) e pranuar nga peygamberët. *ilhaami* ka rol plotësues, që të lë ta kuptosh më mirë Shpalljen dhe ta zbatosh më mirë, mirëpo gjithmonë i nënshtrohet Shpalljes dhe kurrë nuk mund ta zëvendësojë. *ilhaami* po ashtu është subjektiv dhe personal, kështu që, edhe nëse dikush ndien se po udhëzohet drejt një zgjedhjeje, kjo nuk mund të përdoret për të provuar a kundërshtuar ndonjë gjë, çka përbën një dallim tjetër mes *ilhaam-it* dhe Shpalljes së peygamberëve, të cilët vërtetuan saktësinë e peygamberllëkut të tyre me anë të mrekullive, duke i bërë kështu të detyrueshme mësimet e tyre për ata te cilëve iu dërguan. Të kuptuarit e pozitës së duhur të *ilhaamit* është e një rëndësie sipërore për ndjekësin e shtegut të pastrimit shpirtëror, meqë ky është dallimi kryesor mes sufizmit sunit dhe sufizmit të rremë/të devijuar. Ka një *ilhaam* të përgjithshëm për të gjithë qeniet njerëzore. Allahu tha:

“Dhe pasha shpirtin/nefsin/njeriun dhe Atë që i dha proporcione të drejta dhe e frymëzoi për çfarë është mosbindje ndaj Tij dhe çfarë është devotshmëri ndaj Tij.” (esh-Shems, 7-8)

Të gjitha krijesat pranojnë njëfarë *ilhaami* nga Allahu për rolet dhe funksionet që kanë. Allahu tha:

nganjëherë të jetë e paarritshme, kurse *ilhaami* mund të kihet vetëm në një shkallë fisnike të qëndrueshmërisë. Kjo ka tri nivele.

Niveli i parë: Një fakt që transmetohet nëpërmjet një frymëzimi të caktuar (*wahji*), me ose pa pjesëmarrjen e dëgjimit.³

Niveli i dytë është një frymëzim që manifestohet në realitet. Shenjat për vërtetësinë e këtij frymëzimi janë:

- Nuk shqyen perdet⁴
- Nuk tejkalon kufijtë⁵
- Nuk gabon kurrë

Niveli i tretë është një frymëzim që:

“Zoti yt frymëzoi bletën: Shfrytëzo malet, shtëpitë, pemët dhe atë çfarë ata bëjnë/ndërtojnë.” (en-Nehl, 68)

Frymëzimi për të cilin shejhu (el-Harawi) flet këtu, është një frymëzim i veçantë për njerëz të veçantë, për shpirtat e transformuar, që meritojnë udhëzimin më të nevojshëm të zemrave.

² *Muhaddeth* është diateza pësore e *muhaddith*. *Hadiith* do të thotë e folur, tregim, etj. Ai që flet, është *muhaddith*; ndërsa *muhaddeth* është ai të cilit i flitet. Aisha ؓ përcolli se i Dërguari i Allahut ﷺ tha:

“Ndër popujt që erdhën para jush ka pasur persona të frymëzuar (*muhaddethuun*). Nëse ka ndonjë të tillë në umetin tim, ai është Umer bin Khatab.” (Mtf)

Imam Ibn Tejmije reflektoi për këtë dhe shpjegoi se arsyeja përse popujt para nesh patën më shumë kësi *muhaddethuun*, ndërsa pejgamberi ﷺ tha ‘Nëse ka ndonjë të tillë në umetin tim’, është se pejgamberi i këtij umeti u la atyre një shteg të qartë, i cili do t’u mjaftojë, nëse e ndjekin. Po ashtu vlen të përmendet se Umeri ؓ asnjëherë nuk kundërshtoi Kuranin ose Sunetin me frymëzimin që shprehte, gjë që përbën formën më të lartë të *ilhaamit* që mund të ketë një jopejgamber.

³ Në disa dorëshkrime, ky nivel nis me “frymëzimin e një pejgamberi” në vend të “një fakti”, pas çka kuptimi i nivelit pritet të jetë i vetëkuptueshëm. Mirëpo, problemi në këtë version qëndron te rendi i tri niveleve, meqë shejhu (el-Harawi) zakonisht rendit nivelet sipas rëndësisë.

⁴ Mes personit dhe shkallëve (stacioneve) që pritet të zbulohen; ose nënkupton se kjo nuk shtyn personin t’i shqyjë perdet që s’i lënë njerëzit ta dinë gjendjen e tij, gjë që mund t’i shkaktojë sprova të mëdha.

⁵ Nuk e bën personin t’i tejkalojë kufijtë e fesë gjatë pranimit të *ilhaamit* ose pas pranimit të tij.

- Çon pashmangshëm në vërtetimin përfundimtar⁶
- Flet qartazi për para-ekzistencën⁷
- Zeniti tek i cili çon *ilhaami*, është i papërshkrueshëm⁸

⁶ Që është gjendja e të parët (*shuhuud*) e të Vetmit. Të parët që e bën çdo gjë tjetër (*siwa*) të zhduket praktikisht nga të parët, ndonëse nuk pushon së ekzistuari.

⁷ Të parët (*shuhuud*) e kësaj kohe e bën personin t'i kushtohet vetëm Atij që ekzistonte edhe atëherë.

⁸ Vetëm ata që janë atje kuptojnë çfarë ka atje.